



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Kuvendi

PROJEKT LIGJ

Nr. ____/2019

PËR

DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR.12/2018,
“PËR VLERËSIMIN KALIMTAR DHE PERIODIK TË PUNONJËSVE
TË POLICISË SË SHTETIT, GARDËS SË REPUBLIKËS
DHE SHËRBIMIT PËR ÇËSHTJET E BRENDSHME DHE ANKESAT
NË MINISTRINË E BRENDSHME”

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pikat 1 e 2, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë

V E N D O S I:

Në ligjin nr.12/2018, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

1. Pika 4, e nenit 3, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“4. “Organet e vlerësimit kalimtar” janë Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit dhe Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat.”.

2. Pika 21, e nenit 3, shfuqizohet.

Neni 2

1. Pika 1, e nenit 5, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Organet e vlerësimit kalimtar janë Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit dhe Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat.”.

2. Pika 3, e nenit 5, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“3. Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit organizohet në trupa vlerësimi, të cilët veprojnë në mënyrë të pavarur, të paanshme dhe janë përgjegjës për verifikimin, vlerësimin si dhe për marrjen e vendimeve ndaj punonjësve.”.

3. Pika 6, e nenit 5, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“6. Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit mbështetet gjatë veprimtarisë së tij nga një sekretariat teknik, sipas parashikimeve të këtij ligji.”.

Neni 3

1. Shkronja “c”, e pikës 1, të nenit 6, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“c) Punonjësit në Shërbimin për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat.”.

2. Pika 2, e nenit 6, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“2. Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat vlerëson të gjithë punonjësit e tjerë të Policisë së Shtetit dhe Gardës së Republikës.”.

3. Pikat 3 dhe 4, të nenit 6, shfuqizohen.

Neni 4

Neni 13 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“13. Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit ushtron veprimtarinë e tij deri në përfundimin e procesit të vlerësimit për kategorinë përkatëse të punonjësve, sipas nenit 6, të këtij ligji.”.

Neni 5

Nenet 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 21, 22 dhe 23, të këtij ligji, shfuqizohen.

Neni 6

Pika 1, e nenit 24, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit drejtohet nga kryetari ose, në mungesë të tij, nga anëtari më i vjetër në moshë, i caktuar prej tij.”.

Neni 7

Pika 4, e nenit 29, shfuqizohet.

Neni 8

1. Në të gjithë përmbajtjen e ligjit, fjalët “... komisionet e vlerësimit ...” zëvendësohen me “Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit” dhe fjalët “... sekretariateve teknike ...” zëvendësohen me “... sekretariatit teknik pranë Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit ...”.
2. Në të gjithë ligjin, në nenet nga 31 deri 62, pas fjalëve “... trupa e vlerësimit ...” shtohen fjalët “... ose Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat ...”.

Neni 9

Neni 68 shfuqizohet.

Neni 10

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

K R Y E T A R I

GRAMOZ RUÇI